

Gjendja në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK)



Gjendja në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK)



admovere

botues:

ADMOVEVERE

(drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim)

<http://admovere.org/>

për botuesin:

Shkëlzen Gashi

ky raport u hartua nga:

Aulonë Memeti

Ardit Kika

hulumtues:

Aulonë Memeti

Ardit Kika

konsulent:

Arian Maloku

redaktor gjuhësor:

Gazmend Bërlajolli

fotografia në kopertinë:

Gazmend Bajri

dizajni i kopertinës dhe faqosja:

Envinion

shtypi:

Envinion

nëntor 2019

Prishtinë

tirazhi: **300** kopje

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

KFOS (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

ADMOVEVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), të mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së **ADMOVEVERE** dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të KITU-së, e as të recensentëve.

ADMOVEVERE (drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e të bashkëjetesës dhe luftimin e paragjykimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes.

Për më shumë: <http://admovere.org/>

Përmbajtja

- 06** Shkurtesat
- 07** Hyrja
- 09** Falënderimet
- 11** Historiku
- 13** Akreditimet
- 15** Gjendja aktuale e stafit akademik
- 17** Angazhimet, pensionimet dhe konkurset për stafin akademik
- 23** Interesimi, vështirësitë dhe sukseset në studime
- 29** Gjendja sipas profesorëve dhe ekspertëve
- 35** FIEK-u dhe ndërmarrjet energjetike/industriale
- 41** Përfundimet
- 45** Rekomandimet
- 47** Fundnotat

Shkurtesat

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
BA	Bachelor
BE	Bashkimi Europian
PhD	Philosophy Doctorate
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FIMK	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
FNA	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KEDS	Kosovo Electricity Distribution and Supply
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KITU	Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
MA	Master
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
SEMS	Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UMIB	Universiteti i Mitrovicës «Isa Boletini»
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRrE	Zyra e Rregullatorit për Energji

Falënderime

Falënderojmë të gjithë që ndihmuan këtë publikim, në radhë të parë Dekanatin e FIEK-ut, me në krye prof. dr. Enver Hamitin, që na ndihmoi në forma të ndryshme për realizimin e këtij raporti, si dhe me theks të veçantë prodekanen për çështje akademike në FIEK, prof. asoc. dr. Mimoza Ibrani, e cila na i siguroi një mori materialesh pa më të voglën përtesë. Duam t'i falënderojmë edhe profesorët e FIEK-ut që bashkëpunuan duke na dhënë intervista: Avni Skeja, Blerim Rexha, Lavdim Kurtaj, Luan Ahma, Lule Ahmedi, Myzafere Limani, Sabrije Osmanaj, Ruzhdi Sefa dhe Vjollca Komoni. Për disponueshmërinë e intervistimit falënderojmë edhe inxhinierët/ekspertët nga ndërmarrje të ndryshme: Avni Alidemaj, Edita Bytyqi, Gazmend Kabashi dhe Kadri Kadriu.

Po ashtu, kur jemi te materialet duam të falënderojmë posaçërisht prof. asoc. dr. Isak Shabanin, krijues i programit SEMS, dhe Nazime Hasanin, drejtoreshë e shërbimit për studentë. Në fillim të këtij projekti dyshonim se me të njëjtën problematikë mund të përballen edhe drejtime në

Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM) dhe në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës (FNA), por pas hulumtimeve dhe intervistave me drejtues e profesorë në këto dy fakultete, kuptuam se ky dyshim ishte i pabazë. Sido që të jetë, falënderojmë dekanin e FNA-së prof. dr. Abdullah Zejnullahu për gatishmërinë për të na ndihmuar. Po ashtu, falënderojmë për ndihmën e pakursyer edhe stafin e FIM-in: dekanin Ahmet Shala, prodekanin Ilir Doçi, prodekanin Shpëtim Lajçi e sekretaren Fatmire Kuçi, si dhe profesorët për gatishmërinë e tyre për t'u përgjigjur në pyetjet tona: Arbnor Pajaziti, Xhevat Berisha, Beqir Hamidi, Azem Kycyku dhe Hysni Osmani.

Një falënderim të veçantë meritojnë drejtuesit e ndërmarrjeve, që na ndihmuan me të dhëna të ndryshme: në KEK, Isak Kerolli, zëvendës-drejtor Teknik, si dhe Skënder Bucolli, drejtor i zyrës për marrëdhënie me publikun; në KOSTT, Ilir Shala, kryeshef ekzekutiv, Ibrahim Gashi, drejtor i departamentit të burimeve njerëzore, si dhe Dafina Morina, asistente



e kryeshefit ekzekutiv; në KEDS, Alper Erbaş, kryeshef ekzekutiv, Valbona Kadrijaj, drejtoreshë e departamentit të burimeve njerëzore; në TREPÇA, Bajram Mustafa, drejtor i departamentit për zhvillim, hulumtim dhe mjedis; në INFRAKOS, Agron Thaçi, kryeshef ekzekutiv, dhe Bahrie Sylejmani-Gashi, menaxhere e burimeve njerëzore; dhe në ContourGlobal, Larissa Testoni, menaxhere e fondit për zhvillimin e komunitetit.

dhe botimin e këtij raporti, Arian Malokun për udhëzimet, sugjerimet dhe vërejtjet e vlefshme, Gazmend Bërlajollin për redaktimin gjuhësor, Gazmend Bajrin për fotografimin e kopertinës, Kombëtar Uskanën e Faton Selanin nga Envinion për dizajnin e faqesjen, si dhe Arian Mumxhiun nga Printing Press për shtypin e këtij raporti.

Në fund, falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) për mbështetjen financiare për hulumtimin

Hyrja

Profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit të Prishtinës (UP) kanë alarmuar publikisht për rrezikun e mbylljes së programit studimor të elektroenergjetikës në këtë fakultet. Duke pasur parasysh se është fjala për profil studimi që nuk ofrohet nga asnjë institucion i lartë arsimor tjetër në Kosovë, ç'pasoja do të sillte mbyllja e këtij programi studimor për ekonominë dhe industrinë e vendit, në afat të mesëm e të gjatë? Ky publikim fokusohet në rrezikun e mbylljes së programit të elektroenergjetikës në FIEK, si dhe te pasojat e mbylljes së tij. Shqyrtohen edhe numrat e regjistrimeve të studentëve në të gjitha nivelet për drejtimet përkatëse të FIEK-ut në këto vitet e fundit, për të mësuar sa joshëse janë ato për studime. Raporti synon të nxisë debat publik mbi këtë çështje të rëndësishme, në mënyrë që të shtohet presioni te organet vendimmarrëse për ta evituar mbylljen e këtij drejtimi.

Në fillim të këtij projekti dyshonim se me të njëjtën problematikë mund të përballen edhe programe studimore në

Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM) dhe në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës (FNA). Megjithatë, pas hulumtimeve dhe intervistave me drejtues e profesorë në këto dy fakultete, kuptuam se ky dyshim ishte i pabazë.

Për të mësuar nëse ekziston rreziku i mbylljes së ndonjërit nga programet studimore në FIEK, nëpër departamente hulumtuam të dhënat e mëposhtme që nga viti 2012, kur u digjitalizuan me Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Studentëve (SEMS), e deri më 2019:

- CV-të e stafit aktual të rregullt akademik dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm;
- listat e personelit akademik me marrëdhënie të rregullt pune dhe lista e bashkëpunëtorëve të jashtëm të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime;
- listën e profesorëve të pensionuar në dhjetë vjetët e fundit;
- konkurset për pozita të rregullta mësimdhënëse;

- pasqyrat e numrit të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike;
- rezultatet e konkurseve për bursa nga UP-ja;
- numrin e studentëve të FIEK-ut që kanë marrë bursa nga këto ndërmarrje;

Përveç këtyre, për t'i hetuar pasojat nga mbyllja e programeve të caktuara në FIEK me të cilat mund të ballafaqohen disa nga ndërmarrjet më të mëdha energjetike/industriale në vend (KEK, KOSTT, KEDS, TREPÇA dhe INFRAKOS), si dhe për ta kuptuar gjendjen aktuale të këtyre ndërmarrjeve lidhur me kuadrot, hulumtuam edhe për:

Po ashtu, për këtë raport zhvilluam edhe intervista me Dekanatin e FIEK-ut, përgjegjësit dhe ish-përgjegjësit e departamenteve në FIEK, me profesorë dhe ish-profesorë të FIEK-ut, si me inxhinierë/ekspertë të drejtimeve elektroteknike nga vetë industria.

- sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen këto ndërmarrje lidhur me kuadrot e reja profesionale;
- profilet profesionale më të kërkuara nga këto ndërmarrje;
- programet studimore në FIEK nga të cilat kërkohen të diplomuar për punësim në këto ndërmarrje;
- numrin e inxhinierëve të punësuar në këto ndërmarrje dhe moshën mesatare të tyre;
- numrin e inxhinierëve të pensionuar në 10 vjetët e fundit;
- numrin e inxhinierëve që do të pensionohen në 10 vjetët e ardhshëm;
- numrin e të diplomuarve nga FIEK-u të punësuar nga këto ndërmarrje në 10 vjetët e fundit;
- numrin e studentëve të FIEK-ut që kanë kryer praktikë në këto ndërmarrje në 10 vjetët e fundit;

Historiku

Në vitin 1961 u themelua Shkolla e Lartë Teknike, e cila në vitin 1965 u shndërrua në Fakultetin Teknik në kuadër të Universitetit të Beogradit. Në këtë kohë, ky institucion kishte vetëm seksionin e ndërtimtarisë, e më pas e hapi edhe seksionin e makinerisë dhe të elektroteknikës. Kur u themelua Universiteti i Prishtinës (UP) në vitin 1970, Fakulteti Teknik u bë pjesë e UP-së. Në vitin 1988 Fakulteti Teknik u nda në Fakultetin e Makinerisë, të Elektroteknikës dhe atë të Ndërtimtarisë e të Arkitekturës. Historiku i FIEK-ut mund të ndahet në tri periudha:

Periudha e parë janë dy dekadat e para të funksionimit të Fakultetit Teknik (1971-1991) – pjesë e të cilit ishte FIEK-u – që karakterizohen me rritje të numrit të studentëve e të stafit akademik, ndërtime të objekteve të reja dhe të laboratorëve shoqëruar, aktivitete hulumtuese e shkencore, botime e publikime, vendosje të bashkëpunimeve ndërkombëtare, e me radhë.

Periudha e dytë përfshin vitet 1991-1999, që ishin më dramatike, ngaqë regjimi serb me Slobodan Milošević-in në krye përjashtoi të gjithë studentët dhe stafin akademik e administrativ shqiptar nga UP-ja, përfshirë këtu edhe stafin e FIEK-ut, duke i detyruar që ta vazhdojnë punën në kushte jashtëzakonisht të vështira nëpër shtëpi private. Kjo periudhë karakterizohet me rënie të cilësisë së

studimeve, kjo për shkak të mungesës së ushtrimeve laboratorike gjatë studimeve, ikjes së një pjese të kuadrit cilësor nga vendi, ndërprerjes të veprimtarisë shkencore e botuese, si dhe ndërprerjes së pothuajse të gjitha komunikimeve e bashkëpunimeve me universitetet jashtë Kosovës.

Periudha e tretë është ajo pas luftës më 1998-1999, me ç'rast u krijuan kushtet për kthim në objektet e fakulteteve të UP-së e për rifillimin e punës, si dhe nisën përpjekjet për ngritjen e cilësisë në këtë fakultet, duke filluar nga reformimi i tij i bazuar në Procesin e Bolonjës. Arritjet e tjera që e karakterizojnë periudhën e pasluftës janë renovimi i hapësirave administrative e të mësimdhënies, pajisja me laboratorë bashkëkohorë, reformimi i drejtimeve të studimeve dhe rekrutimi i stafit të ri akademik. Në këtë periudhë FIEK-u zhvilloi projekte të shumta për ngritjen e resurseve njerëzore dhe programe të përbashkëta të ligjëratave dhe të ushtrimeve laboratorike me disa universitete në BE dhe në ShBA. Për ta rritur bashkëpunimin me industrinë e vendit, gjatë kësaj periudhe FIEK-u themeloi Bordin Industrial Këshillëdhënës, në përbërje të të cilit i kishte përfaqësuesit e industrisë së Kosovës.

Akreditimet

Procesi i akreditimit të planprogrameve mësimore të arsimit të lartë në Kosovë ka filluar në vitin 2009. Njëri prej kritereve bazë për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) për secilin program të studimeve është që në marrëdhënie të rregullt pune të ketë anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore PhD: tre në nivelin BA, dy në nivelin MA dhe tre në nivelin PhD . Më poshtë po i paraqesim akreditimet e fundit në nivelet BA, MA dhe PhD:

- **Në nivelin BA**, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) në vitin 2014 i akreditoi pesë programe studimi – automatikë e kompjuterizuar dhe robotikë, elektroenergjetikë, elektronikë, inxhinieri kompjuterike dhe telekomunikacion – për periudhën pesëvjeçare (2014-2019). Të gjitha këtyre programeve të studimit, për shkak të mosfunksionimit të Bordit të AKA-së, më 2018 AKA-ja ua zgjati akreditimin edhe për një vit për periudhën 2019-2020.
- **Në nivelin MA**, po në vitin 2014, AKA-ja i akreditoi pesë drejtime – automatikë e kompjuterizuar dhe robotikë, elektroenergjetikë, elektronikë, inxhinieri kompjuterike dhe telekomunikacion – për periudhën pesëvjeçare (2014-2019). Mirëpo, tre vjet më vonë, më 2017, AKA-ja e pezulloi për një vit (2017-2018) akreditimin e tri drejtimeve në nivelin MA – automatikë e kompjuterizuar e robotikë, elektroenergjetikë dhe elektronikë – me arsyetimin se nuk kishin të paktën dy pjesëtarë të stafit akademik me gradën PhD në marrëdhënie të rregullt pune. Më 2018 AKA-ja për periudhën 2019-2020 ua zgjati akreditimin edhe për një vit programeve të studimit: elektronikë, inxhinieri kompjuterike dhe telekomunikacion, por jo edhe programeve automatikë e kompjuterizuar e robotikë, dhe as elektroenergjetikë, ngaqë nuk kishin në marrëdhënie të rregullt pune asnjë mësimdhënës me PhD.

- **Në nivelin PhD**, AKA-ja në vitin 2013 mori vendim që të akreditonte katër drejtime për periudhën 2013-2016: automatikë, sisteme energjetike dhe elektronikë energjetike, shkenca kompjuterike dhe telekomunikacion. Në drejtimin automatikë dhe në drejtimin sisteme energjetike dhe elektronikë energjetike nuk u pranua asnjë student. Në automatikë nuk u pranua asnjë student ngaqë akreditimi ishte i kushtëzuar. Në këto drejtime duhej të punësohej nga një profesor i ri për fushën përkatëse, por asokohe nuk kishte kandidatë potencialë me doktoratë në këto fusha. Në shkencat kompjuterike u pranuan pesë studentë, por deri më tani vetëm njëri ka doktoruar; dy janë nxjerrë nga lista e të pranuarve qysh në fillim për shkak të ndryshimit të kriterëve, por vjet janë kthyer me vendim të gjykatës; dy të tjerë janë ende në proces të studimeve. Në drejtimin telekomunikacion janë

pranuar tre studentë doktorate dhe të tre e kanë përfunduar studimin. Aktualisht, FIEK-u ka vendosur të riaplikojë për vitin akademik 2020-2021 me vetëm një program të doktoratës – inxhinieri elektrike dhe kompjuterike – ku do të pranohen 10 kandidatë, për t'i përmbushur kërkesat e tregut aktual të Kosovës për studimet e këtij niveli. Për këtë program janë rezervuar kuadri dhe infrastruktura e nevojshme.


Më 2017, AKA-ja e pezulloi për një vit akreditimin e tri drejtimeve në nivelin MA – automatikë e kompjuterizuar e robotikë, elektroenergjetikë dhe elektronikë – me arsyetimin se nuk kishin të paktën dy pjesëtarë të stafit akademik me gradën PhD në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjendja aktuale e stafit akademik

FIEK-u aktualisht ka gjithsej 24 profesorë me marrëdhënie të rregullt pune (15 burra e 9 gra), prej të cilëve 7 profesorë të rregullt, 10 profesorë të asocuar dhe 7 profesorë asistentë. Mosha mesatare e profesorëve të rregullt është 58 vjeç, e profesorëve të asocuar 51, e profesorëve asistentë 50. Mosha mesatare e të gjithë profesorëve me angazhim të rregullt të FIEK-ut është 53 vjeç. FIEK ka gjithsej 1049 studentë të rregullt BA dhe MA, që do të thotë se përpjesa profesor-studentë gjatë procesit të ligjëratave është 1:43, e nëse i shtojmë edhe studentët përsëritës që hyjnë vetëm në provime (782 studentë),

atëherë përpjesa profesor-studentë rritet në 1:76. Nga ky fakultet, 9 pjesëtarë të stafit akademik janë të angazhuar edhe në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë publik ose privat. Gjysma e stafit akademik të FIEK-ut i kanë përfunduar studimet të paktën në njërin nivel jashtë vendit në gjuhë të huaj, kurse gjysma tjetër janë me formim akademik tërësisht vendor. Asnjë pjesëtar i stafit nuk i ka përfunduar të gjitha nivelet e studimit jashtë vendit e në gjuhë të huaj. Vetëm 5 pjesëtarë të stafit akademik i kanë mbaruar studimet PhD jashtë vendit e në gjuhë të huaj.

Gjendja aktuale e stafit akademik





Angazhimet, pensionimet dhe konkurset për stafin akademik

Për të pasqyruar angazhimet e stafit akademik në FIEK në periudhën 2012-2019, kemi shqyrtuar listat e angazhimeve të rregullta e të jashtme të stafit akademik, pensionimet e profesorëve, dhe konkurset për pozita të rregullta mësimdhënëse (profesorë të rinj, rishpallje dhe avancim të pozitave). Duhet sqaruar se nuk kemi shqyrtuar pozitat e shpallura për lëndët bazike të shkencave ekzakte (matematikë dhe fizikë) meqë këto nuk ndikojnë në akreditimin e programeve, dhe se në vitet 2014 dhe 2017 nuk ka pasur konkurse. Nga të dhënat e mësipërme paraqesim angazhimet, pensionimet dhe shpalljet e konkurseve për stafin akademik të FIEK-ut nëpër departamente:

Në **automatikë** për çdo vit akademik kanë qenë vazhdimisht të angazhuar së paku dy profesorë të rregullt. Viteve të fundit janë pensionuar dy profesorë të rregullt. Në këtë periudhë janë shpallur konkurse për tri pozita të rregullta mësimdhënëse, mirëpo në konkursin e vitit 2013 për pozitën ‘profesor i rregullt në automatikë’ nuk është paraqitur asnjë kandidat. Prandaj, mungesës së profesorëve të rregullt, departamenti i është përgjegjur duke angazhuar profesorë të jashtëm, numri i të cilëve ka rënë viteve të fundit, dhe në tre vjetët e fundit është shfaqur dukuria e angazhimit të një profesori të pensionuar.

Po ashtu, në këtë departament në periudhën 2012-2019 për çdo vit akademik kanë qenë të angazhuar vazhdimisht së paku dy asistentë të rregullt. Për këtë periudhë me konkurs janë kërkuar gjithsej pesë asistentë të rregullt (dy më 2013, një më 2015, një më 2016 dhe një më 2018), por në konkursin e vitit 2013 për dy pozitat e shpallura nuk është paraqitur asnjë kandidat. Për më tej, në këtë departament gjithmonë ka qenë i angazhuar vetëm një asistent i jashtëm.

Në **elektroenergjetikë** në periudhën 2012-2019 ka pasur vazhdimisht rënie të numrit të profesorëve të rregullt për shkak se janë pensionuar tetë profesorë, mirëpo janë shpallur konkurse vetëm për gjashtë pozita të rregullta mësimdhënëse (dy më 2012, dy më 2016 dhe dy më 2018). Madje, në vitin 2018 njëra nga këto pozita të rregullta mësimdhënëse nuk është plotësuar ngase është paraqitur vetëm një kandidat, i cili nuk i ka plotësuar kushtet statutorë për t'u zgjedhur. Krejt kjo situatë është menaxhuar duke angazhuar profesorë të jashtëm (numri i të cilëve bie vazhdimisht nëpër vite) dhe tre profesorë të pensionuar çdo vit.

Po ashtu, në periudhën 2012-2019 ky departament nuk ka pasur asnjëherë asistentë me angazhim të rregullt. Për këtë periudhë me konkurs janë kërkuar gjithsej pesë asistentë të rregullt (një më 2013, dy më 2016 dhe dy më 2018). Në konkursin e vitit 2013 asnjë kandidat për asistent të rregullt nuk i ka plotësuar kushtet për t'u zgjedhur, ndërsa në konkursin e vitit 2018 janë angazhuar dy asistentë të rregullt,

prej të cilëve njëri më vonë e ka ndërprerë kontratën për shkak të studimeve të doktoraturës jashtë vendit. Duke marrë parasysh se studimet e doktoraturës zgjasin 3-5 vjet, shpallja e konkurseve nuk ka qenë në përputhje me trendin e pensionimeve të profesorëve. Pozitat e asistentëve vazhdimisht janë plotësuar me asistentë të jashtëm, por edhe numri i tyre ka rënë vazhdimisht nëpër vite.

Në **elektronikë** në periudhën 2012-2019 për çdo vit akademik vazhdimisht kanë qenë të angazhuar së paku dy profesorë të rregullt. Viteve të fundit janë pensionuar dy profesorë. Në këtë periudhë me konkurse janë kërkuar gjithsej katër profesorë të rregullt dhe ka qenë i angazhuar mesatarisht një profesor i jashtëm. Në këtë departament nuk është shfaqur dukuria e angazhimit të profesorëve të pensionuar.

Po ashtu, në këtë departament në periudhën 2012-2019 për çdo vit akademik kanë qenë të angazhuar vazhdimisht së paku tre asistentë të rregullt. Për këtë periudhë me konkurse janë kërkuar gjithsej tre asistentë të rregullt. Në këtë departament numri i asistentëve të jashtëm nuk ka ndryshuar ndjeshëm dhe ka qenë minimal.

Në **inxhinieri kompjuterike** në periudhën 2012-2019 për çdo vit akademik kanë qenë të angazhuar mesatarisht katër profesorë të rregullt. Viteve të fundit është pensionuar vetëm një profesor. Në këtë periudhë me konkurse janë kërkuar gjithsej 14 profesorë të rregullt. Vërehet se numri i

profesorëve të jashtëm ka qenë mesatarisht katër dhe se në tre vjetët e fundit angazhohet një profesor i pensionuar.


Në shtatë vjetët e fundit akademikë (2012-2019) numri i asistentëve të rregullt për çdo vit ka qenë mesatarisht katër. Gjatë kësaj periudhe me konkurse janë kërkuar gjithsej 10 asistentë të rregullt. Ky departament dallohet nga të tjerët, përveçse me numrin më të madh të studentëve, edhe me numrin më të madh të asistentëve të jashtëm.

Në **telekomunikacion** në periudhën 2012-2019 për çdo vit akademik kanë qenë të angazhuar vazhdimisht së paku pesë


profesorë të rregullt. Viteve të fundit është pensionuar vetëm një profesor. Në këtë periudhë në konkurse janë kërkuar gjithsej shtatë profesorë të rregullt. Vërehet se numri i profesorëve të jashtëm ka rënë dhe nuk është shfaqur fare dukuria e angazhimit të profesorëve të pensionuar.

Në shtatë vjetët e fundit akademikë (2012-2019) numri i asistentëve të rregullt është rritur vazhdimisht. Për periudhën 2012-2019 me konkurse janë kërkuar gjithsej tre asistentë të rregullt. Numri i asistentëve të jashtëm nuk ka ndryshuar dhe ka qenë mesatarisht tre asistentë.


Angazhimet e rregullta dhe të jashtëme të stafit akademik



Pensionimet e profesorëve në 10 vjetët e fundit



Konkurset për staf akademik





Në konkursin e fundit, të shpallur më 22 tetor 2019, UP-ja ka kërkuar për FIEK-un shtatë mësime të rregullta dhe dy asistentë të rregullt.¹ Në departamentin e telekomunikacionit ka kërkuar një mësime të rregullta, në inxhinieri kompjuterike dy mësime të rregullta dhe një asistent, në automatikë një mësime të rregullta dhe një asistent, si dhe në elektroenergjetikë tre mësime të rregullta, që është numri më i madh i mësime të rregullta të kërkuar për elektroenergjetikë që nga viti 2012.

Për fund, nga ky shqyrtim i listave të angazhimeve të rregullta e të jashtme të stafit akademik, të pensionimeve të

profesorëve, dhe të konkurseve për pozita të rregullta mësime të rregullta në FIEK për periudhën 2012-2019, rezulton se elektroenergjetika dhe automatika kanë shpërputhje mes numrit të profesorëve të pensionuar dhe numrit të profesorëve të rinj e të asistentëve të rinj të kërkuar me konkurs. Mirëpo, shpërputhja del edhe më e madhe kur të kihet parasysh se këto konkurse jo domosdoshmërisht janë shpallur për pozita të reja, por ka pasur edhe rishpallje e avancime të pozitave mësime të rregullta ekzistuese.

Interesimi, vështirësitë dhe sukseset në studime

Hulumtuam pasqyrat e numrave të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike në BA dhe në MA, përfshirë këtu edhe raportin gjinor, si dhe rezultatet e konkurseve për bursa nga UP-ja, për ta evidentuar interesimin e të rinjve për studime të shkencave të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike në FIEK gjatë periudhës 2012-2019, por edhe vështirësitë dhe suksesin e tyre gjatë studimeve.

Regjistrimi i studentëve të rinj

Drejtimi i inxhinierisë kompjuterike prin me regjistrimin më të madh dhe më stabil të studentëve të rinj në periudhën

2012-2019. Numri mesatar i studentëve të regjistruar në këtë drejtim shënon rritje të lehtë përgjatë viteve. Drejtimi i elektroenergjetikës, i përbërë fillimisht nga sistemet elektroenergjetike dhe elektroenergjetika industriale, në periudhën 2012/13 - 2015/16 për nga numri mesatar i studentëve të rinj të regjistruar ishte i njëjtë me drejtimin e inxhinierisë kompjuterike, mirëpo në tre vjetët e fundit shënon gati përgjysmim. Përgjysmim të tillë ka pasur edhe drejtimi i automatikës, kurse drejtimi i telekomunikacionit dhe ai i elektronikës kanë shënuar rënie, por të lehtë.

Regjistrimi për herë të parë në vitin e parë - FIEK BA

Departamentet	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
Inxhinieri kompjuterike	138	327	133	146	172	162	169
Elektroenergjetikë	140	152	134	119	89	73	76
Automatikë	72	66	69	52	49	27	38
Telekomunikacion	78	102	80	81	61	61	52
Elektronikë	77	81	71	62	47	36	48

Kalueshmëria e studentëve në BA dhe MA


Nga pasqyrat e numrit të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike shihet se gjatë periudhës 2012-2019 në të gjitha drejtimet e FIEK-ut në vitin e parë janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 477 studentë për herë të parë. Në vitin e dytë janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 244 studentë, ndërsa në të tretin nga 201 studentë.

Nga pasqyrat e numrit të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike shihet se gjatë periudhës 2012-2019 në të gjitha drejtimet në FIEK në vitin e parë, për herë të dytë e më shumë janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 288 studentë përsëritës. Në vitin e dytë janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 189, e në të tretin nga 485 studentë përsëritës.

Kushti për të kaluar në vitin vijues të studimeve nënkupton përfundimin e së paku 7 prej 10 provimeve të vitit aktual. Nga të dhënat e mësipërperme duket se studentët kanë vështirësi për të kaluar nga viti i parë në të dytin, si dhe nga i dyti në të tretin.

Vërehet se në vitin e dytë të studimeve numri i studentëve të regjistruar për herë të parë është përgjysmuar, nga 477 studentë në 244 studentë, ndërkaq në vitin e tretë ka rënie të lehtë nga 244 në 201 studentë. Po ashtu vërehet se numri i studentëve të regjistruar për herë të dytë e më shumë është më i madh në vitin e parë, e sidomos në vitin e tretë. Madje, numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (477) është pothuajse i njëjtë me numrin e studentëve përsëritës të regjistruar në vitin e tretë (485).

Mesatarja e regjistrimeve të studentëve nëpër vite të studimeve BA




	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Regjistrimet për herë të parë	477	244	201
Regjistrimet për herë të dytë e më shumë	288	189	485

Nga pasqyrat për studimet MA shihet se gjatë periudhës 2012-2019 në të gjitha drejtimet në FIEK në vitin e parë të studimeve **për herë të parë** janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 81 studentë, ndërsa në vitin e dytë nga 50 studentë. Gjatë po kësaj periudhe, në vitin e parë të studimeve MA **për herë të dytë e më shumë** janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 24 studentë, ndërsa në vitin e dytë për herë të dytë e më shumë janë regjistruar për çdo vit mesatarisht nga 160

studentë. Numri më i madh i studentëve përsëritës në MA është në vitin e fundit të studimeve. Përderisa në nivelin BA numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë është pothuajse i njëjtë me numrin e studentëve të regjistruar në vitin e tretë, në nivelin MA numri total i studentëve të regjistruar në vitin e dytë është dyfish më i madh se në vitin e parë. Do të thotë, ka zvarritje të kohëzgjatjes së studimeve në nivelin MA.

Mesatarja e regjistrimeve të studentëve nëpër vite të studimeve MA



	Viti 1	Viti 2
Regjistrimet për herë të parë	81	50
Regjistrimet për herë të dytë e më shumë	24	160

Në nivelin BA numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë është pothuajse i njëjtë me numrin e studentëve të regjistruar në vitin e tretë.

Në nivelin MA numri total i studentëve të regjistruar në vitin e dytë është dyfish më i madh se në vitin e parë.


Bursat

Në periudhën 2012-2019 numri i studentëve të FIEK-ut të të gjitha drejtimeve që kanë fituar bursë nga UP-ja është 315.

Prej tyre ¾ janë studentë që kanë marrë bursë për vitin e parë të studimeve, ndërsa

vetëm ¼ kanë arritë të marrin bursë për vitin e dytë. Kjo tregon mbi vështirësitë e studentëve për t'i përfunduar të gjitha provimet e vitit të dytë me notë mesatare mbi 8, që është kushti për të marrë bursë.


Numri i burasve të fituara



Sa i takon ndarjes së burasve sipas drejtimeve në FIEK, vërehet se ¾ e burasve i kanë marrë studentët e inxhinierisë kompjuterike, ata të elektroenergjetikës dhe

të telekomunikacionit kanë marrë nga 10% të burasve, kurse më së paku bursistë kanë pasur elektronika (4%) dhe automatika (1%).

Numri i burasve sipas programeve studimore



75% ■ Inxhinieri kompjuterike

10% ■ Telekomunikacion

4% ■ Elektronikë

1% ■ Automatikë

10% ■ Elektroenergetikë

Gjendja sipas profesorëve dhe ekspertëve

Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të stafit të rregullt e të angazhuar akademik të FIEK-ut, por edhe me përgjegjësit dhe ish-përgjegjësit e departamenteve në FIEK, rezulton se ka rrezik që të mbyllet drejtimi i **elektroenergjetikës**. Madje, njëri nga profesorët e intervistuar thotë se ka gjasa që të mbyllet edhe drejtimi i **automatikës**, e më vonë ndoshta edhe drejtimi i **telekomunikacionit**.² Rrezikun për këto dy drejtime, madje duke shtuar edhe drejtimin e **elektronikës**, e theksojnë edhe profesorë të tjerë.³ Mirëpo, profesoresha Myzafere Limani thotë se në drejtimin e elektronikës dhe atë të automatikës është tejkaluar kjo situatë, sepse janë shpallur konkurse dhe janë punësuar profesorë të rregullt, por kështu nuk ka ndodhur edhe në drejtimin e telekomunikacionit, ndonëse kuadrot janë të gatshme.⁴ Kurse,

sipas profesorit Lavdim Kurtaj, me akreditimin e ri imponohet shkrimi e drejtimin të elektronikës dhe atij të automatikës në një drejtim të vetëm, për shkak të mungesës së stafit akademik të rregullt.

Nga ana tjetër, profesoresha Mimoza Ibrani, prodekane për çështje akademike, thotë se nuk ka rrezik që të mbyllet asnjëri drejtim në FIEK, përveç elektroenergjetikës, e madje edhe ky mund të mbyllet vetëm nëse dështon konkursi i shpallur më 22 tetor 2019 për profesorë të rregullt.⁵

Të gjithë të intervistuarit ishin të mendimit se shkaktari kryesor që mund ta sjellë mbylljen e programeve studimore në FIEK, e veçanërisht të elektroenergjetikës, është pensionimi i stafit të rregullt akademik. Kjo situatë


është rënduar sidomos viteve të fundit, meqë stafi i rregullt akademik i FIEK-ut i ka takuar gjeneratës së njëjtë, çka ka bërë që brenda një viti të pensionohen nga disa profesorë përnjëherë.⁶ Gjenerata e mesme, e cila do të duhej t'i zëvendësonte profesorët e pensionuar, pas luftës 1998-1999 nuk pati interesim për akademi, sepse gjeti punë me të ardhura më të mëdha.⁷ Profesor Gazmend Kabashi, i punësuar në KOSTT, konfirmon se një pjesë e madhe e inxhinierëve, përkatësisht profesorëve potencialë në FIEK, e braktisën akademinë pas luftës dhe u angazhuan në industri për shkak të pagave më të mëdha.⁸

Përveç pensionimit, shkaktar tjetër është mospërtëritja e stafit akademik në FIEK. Njëra prej arsyeve për këtë është se viteve të fundit ka munguar programi për studimet PhD.⁹ Tre vjet ka qenë i akredituar programi për studime të doktoratës në elektroenergjetikë, mirëpo asnjë student nuk ka arritur të regjistrohet meqë UP-ja nuk ka hapur konkurs. Sipas profesoreshës Vjollca Komoni, atëherë na është thënë se konkursi nuk mund të hapet për shkak të mungesës së stafit akademik për t'i udhëhequr studentët.¹⁰ Mirëpo, dekani i FIEK-ut, Enver Hamiti, thotë se programi i doktoraturës për elektroenergjetikë ka qenë i akredituar për periudhën 2013-2016, por UP-ja nuk ka arritur të shpall konkurs për doktoraturë në programin e elektroenergjetikës deri në fund të vitit 2016 për shkak të problemeve me ndërrimet e rektorëve, e në fund të vitit 2016 ka përfunduar akreditimi për këtë program.

Profesoresha Vjollca Komoni thotë se nuk kanë arritur ta krijojnë gjeneratën e re për dy arsye: studentët e mirë i merrte tregu i punës me paga shumë më të mëdha sesa universiteti, si dhe meqë u vinin studentë me sukses jo të mirë, që nuk mund të përgatiteshin për mësimdhënie në universitet.¹¹ Sipas saj, disa herë kanë dështuar konkurset për shkak të mosinteresimit të kandidatëve,¹² e sipas profesorit Ruzhdi Sefa kishte edhe raste kur konkurset dështonin për shkak të kandidatëve të dobët.¹³

Profesoresha Komoni thotë se kjo situatë është menaxhuar duke angazhuar staf të jashtëm, që sipas saj përbën gabim, sepse nuk mbahet fakulteti me staf të jashtëm.¹⁴ Profesor Kabashi konfirmon se shumica e asistentëve në FIEK pas luftës 1998-1999 ishin me angazhim të jashtëm e jo të rregullt, ngase kjo kishte kosto më të vogël për UP-në, megjithëse herë pas here janë hapur konkurse për asistentë të rregullt, por jo për numër të mjaftueshëm.¹⁵

Profesorë të FIEK-ut thonë se ka kandidatë nëpër ndërmarrje të ndryshme, si KEK, KEDS, etj., që kanë doktoratura nga universitete të njohura të Europës, e që nuk u është bërë vend për të qenë të rregullt, por vetëm të angazhuar.¹⁶ Mirëpo, shumë prej këtyre kandidatëve nuk kanë qenë të interesuar për karrierë akademike, jo vetëm për shkak të diferencës në të ardhura,¹⁷ por edhe për shkak të procedurave të tejzgjatura burokratike për pranimin e stafit të ri.¹⁸ Megjithatë, ka kandidatë me PhD në fusha të caktuara, që për pranim në UP shpesh nuk i plotësojnë



kriteret e kërkuara me statut dhe rregullore përkatëse, si për shembull, me numrin e publikimeve në revista kredibile.¹⁹

Në anën tjetër, profesor Luan Ahma thotë se për të pranuar kuadro të reja, UP-ja fillimisht duhet të marrë leje nga Ministria e Financave për rritje të stafit.²⁰ Të njëjtën gjë e pohon edhe profesor Ruzhdi Sefa: «Në drejtimin e elektroenergjetikës gjithëherë është parashtruar kërkesa për hapjen e konkurseve për asistentë të rregullt të rinj, por gjithëherë këto kërkesa janë refuzuar me arsyetime të paqëlluara si: nuk ka kandidatë seriozë, nuk ka mjete financiare, nuk po lejon Rektorati/ Ministria e Financave».²¹

Një tjetër pengesë që e nënvizojnë disa nga të intervistuarit është kriteri moshor – 30 vjeç për asistentët e 50 vjeç për profesorët – e që sipas tyre është diskriminues. Kriteret statutare të UP-së për punësimin e asistentëve universitarë e rëndojnë situatën e mungesës së stafit akademik. Neni 178 i Statutit përcakton se kandidatët duhet të jenë jo më shumë se 30 vjeç kur emërohen për herë të parë, e jo më shumë se 40 vjeç nëse kanë gradën e doktorit të shkencës. Ngjashëm, neni 177 bën kufizim moshor për punësimin e profesorëve (të rregullt, të asocuar dhe asistentë), për të cilët nuk lejon moshën mbi 50 vjeç nëse zgjidhen për herë të parë.²² Madje, të intervistuarit përmendin

edhe padinë që Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka dërguar në gjykatë, e cila ka vendosur në favor të IAP-së.²³ IAP i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës dhe Rektoratit të UP-së që të rishqyrtojë vendimin e Senatit të UP-së i cili kufizon moshën për t'u zgjedhur mësimdhënës dhe Kuvendit që t'i kërkojë të gjitha institucioneve ta ndalojnë praktikën e diskriminimit moshor në punësim.²⁴

Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori aktgjykimin i cili anuloi vendimin e Senatit të UP-së të datës 25 maj 2010 me numër 1/499²⁵ dhe aprovoi rekomandimin e IAP-së si të bazuar. Sipas paditësit, vendimi i Senatit të UP-së shkel Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Kundër Diskriminimit, Ligjin e Punës dhe Ligjin për Shërbimin Civil, duke e kufizuar moshën 50 vjeçare për mësimdhënie. Gjykata vlerësoi se Senati i UP-së nuk ka dhënë arsyetim se mbi çfarë baze ligjore ka bërë kufizimin e moshës. Sipas Gjykatës, ky vendim i Senatit është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Administrative dhe është nxjerrë në kundërshtim me Statutin e UP-së, me Kushtetutën e Kosovës dhe aktet e tjera nënligjore.²⁶ Ankesa më e re ndaj diskriminimit moshor në kandidimet për staf akademik është e datës 29 tetor 2018. Kjo është ende në proces gjyqësor, në Gjykatën e Apelit, ndërsa opinioni juridik i IAP-së është dërguar më 2 gusht 2019.²⁷ Senati i UP-së nuk ka votuar ndonjë statut tjetër. Vazhdimin e zbatimit të këtyre kritereve moshore nga UP e kanë konfirmuar edhe dy intervista të ADMOVERE-s.^{28 29}

Po qe se mbyllen drejtime të caktuara në kuadër të FIEK-ut, veçanërisht elektroenergjetika, atëherë pasojat afatgjate janë të paparashikueshme, ndërsa te ato afatmesme hyn mungesa e kuadrove inxhinierike për ndërmarrjet energjetike ekzistuese (KEK, KOSTT, KEDS, etj.), por edhe për gjithë ekonominë e Kosovës, meqë nuk do të mund të funksionojë sistemi elektroenergjetik i Kosovës. E gjithë kjo për arsye se FIEK-u është i vetmi fakultet që ofron program studimor të akredituar e që prodhon kuadro për sistemin elektroenergjetik në krejt Kosovën.

Duke pasur parasysh sa u tha më sipër, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Vadrin Lluka, dhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Marjan Dema, më 1 mars 2019 nënshkruan një marrëveshje, sipas të cilës Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me aktorët kryesorë të sektorit energjetik – ZRRR, KEK, KOSTT dhe KEDS – do të marrin në mënyrë të vazhdueshme studentë të elektroenergjetikës për praktikë me pagesë. Kjo do të shërbejë që studentët ta fitojnë përvojën sipas nevojave të tregut, gjë që do t'u ndihmojë edhe për punësim. Ditën kur u nënshkrua marrëveshja mes ministrit Lluka dhe rektorit Dema, Ministria e Zhvillimit Ekonomik pati njoftuar se së shpejti do të sigurojë një fond bursash për studentët e elektroenergjetikës, me qëllim që t'u japë një shtytje shtesë të rinjve që ta ndjekin këtë drejtim me perspektivë për të ardhmen.

Iniciativa për bursa ka pasur edhe nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes

projektit pesëvjeçar (tetor 2014-tetor 2019) “Repower Kosovo”, i cili ka mbajtur katër raunde të praktikave (ZrRE, KEK dhe KOSTT) ku qenë përfshirë 63 studentë (34 studente dhe 29 studentë), nga RIT Kosovo dhe nga UP-ja.³⁰ Një tjetër projekt ishte “Women in Energy”, i filluar më 20 shkurt 2019, nga Milenium Foundation Kosovo. Sipas komunikatës së fillimit të projektit, 200 vajza e gra do të përfitojnë nga praktikat me pagesë, ndërsa do të jepet edhe një numër grantesh për gratë në ndërmarrësi. Nga ky projekt janë ndarë 25 bursa për gratë dhe vajzat kosovare për studime në fusha që ndërlidhen me energjinë, për periudhën kohore 2019-2021, në vlerë rreth 1 milion dollarësh. Grupi i parë i bursistëve, sipas MFK, do të ndjekë shkollim në kolegjin “Des Moines Area Community College” në shtetin Iowa në ShBA.³¹

Për më shumë, duke pasur parasysh alarmimet në opinionin publik për rrezikun e mbylljes së drejtimeve të caktuara në FIEK, më 18 prill 2019, me propozim të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Vadrin Lluka, Qeveria e Kosovës aprovoi themelimin e Grupit Punues për të shqyrtuar mungesën e kuadrove dhe të ardhmen e drejtimit elektroenergjetikë në UP. Grupi Punues – i përbërë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Rektorati i UP-së, FIEK-u, Kryetari i Bordit të KShC-së, KOSTT-i, KEK-u, ZRRE-ja, si dhe shoqëria civile – duhet t’i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës një zgjidhje për të ardhmen e drejtimit elektroenergjetikë në UP.³²

Ndonëse për këtë çështje ka pasur takime nga institucione të ndryshme, deri më tani nuk ka diçka konkrete për zgjidhjen e saj, përveç shpalljes së konkursit për staf të rregullt akademik më 22 tetor 2019, që është konkursi me kërkesën për numrin më të madh të mësimdhënësve të rregullt për elektroenergjetikë që nga viti 2012.

FIEK-u dhe ndërmarrjet energjetike e industriale

Me qëllim që t'i shqyrtojmë pasojat me të cilat mund të ballafaqohen ndërmarrjet më të mëdha energjetike e industriale në vend (KEK, KOSTT, KEDS, TREPÇA dhe INFRAKOS) nga mbyllja e drejtimeve të caktuara në FIEK, si dhe për të mësuar mbi gjendjen aktuale të këtyre ndërmarrjeve lidhur me kuadrot, nga këto ndërmarrje siguruam të dhëna për:

- sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen këto ndërmarrje lidhur me kuadrot e reja profesionale;
- profilet profesionale më të kërkuara nga këto ndërmarrje;
- programet studimore në FIEK nga të cilat kërkohen të diplomuar për punësim në këto ndërmarrje;
- numri i inxhinierëve të punësuar në këto ndërmarrje dhe mosha mesatare e tyre;
- numri i inxhinierëve që janë pensionuar në 10 vjetët e kaluar;
- numri i inxhinierëve që do të pensionohen në 10 vjetët e ardhshëm;
- numri i të diplomuarve nga FIEK-u të punësuar në këto ndërmarrje gjatë 10 vjetëve të fundit;
- numri i studentëve të FIEK-ut që kanë kryer praktikë profesionale në këto ndërmarrje në 10 vjetët e fundit;
- numri i studentëve të FIEK-ut që kanë marrë bursa nga këto ndërmarrje;

KEK

KEK-u ka mbi 4 mijë punëtorë, moshë mesatare e të cilëve është rreth 56 vjeç. KEK-u aktualisht ka 365 inxhinierë të punësuar, por të dhënat për moshën mesatare të tyre nuk na u ofruan. Në periudhën 2010-2019 në KEK janë pensionuar 144 inxhinierë, ndërsa në periudhën 2019-2028 pritet të pensionohen 205 inxhinierë. Pra në periudhën afatshkurtër KEK-u përbal-

let me pensionim të inxhinierëve dhe sipas drejtuesve të KEK-ut, sfidë mbetet moshë e shtyrë e tyre, që do të tejkalohet nga prurjet prej FIEK-ut.

Numri i të diplomuarve të punësuar nga FIEK në KEK në dhjetë vjetët e fundit është 112. Shumica dërrmuese e inxhinierëve të punësuar janë nga FIEK në drejtimet elektroenergjetikë dhe inxhinieri kompjuterike.

Në periudhën 2010-2019 në KEK kanë bërë praktikë 310 studentë nga UP, ndërsa gjatë kësaj periudhe KEK-u nuk ka ndarë bursa për studentë të FIEK-ut.

KOSTT

KOSTT-i aktualisht ka 103 inxhinierë të punësuar, moshë mesatare e të cilëve është 45 vjeç. Për periudhën 2010-2018 në KOSTT janë pensionuar 10 inxhinierë, ndërsa për periudhën 2019-2028 pritet të pensionohen 25 inxhinierë. Pra në periudhën afatshkurtër KOSTT-i nuk përballet me pensionim të inxhinierëve, por sipas drejtuesve të KOSTT-it, në periudhën afatmesme mund të ballafaqohet me mungesë të kuadrove. Shumica dërrmuese e inxhinierëve në KOSTT janë të diplomuar nga FIEK-u, kryesisht nga drejtimet elektroenergjetikë, sisteme elektronergjetike, si dhe elektroenergjetikë industriale. Në 10 vjetët e fundit në KOSTT janë punësuar 42 inxhinierë të diplomuar nga FIEK-u (19 me përvojë pune dhe 23 të tjerë që kanë kryer praktikën njëvjeçare, e më pas janë punësuar). Në këtë ndërmarrje janë punësuar 5 inxhinierë të inxhinierisë

kompjuterike të diplomuar në kolegje private.

Në periudhën 2010-2019 në KOSTT kanë bërë praktikë 157 studentë nga FIEK-u, ndërsa gjatë periudhës 2010-2014 KOSTT ka ndarë 48 bursa për studentë të FIEK-ut, në vlerë prej 1.200 eurosh në vit, që në total i bie 57.600 euro. Prej këtyre bursave, 28 kanë qenë për studentët e drejtimet sisteme elektroenergjetike. Kriteret për shpërbllim me bursë ishin: numri i pikëve të pranimit të studentit (më shumë se 70 pikë), nota mesatare mbi 8, mospërsëritja e viteve të studimit; në mesin e aplikuesve me pikë të barabarta u zgjodhën ata me kushte më të rënda ekonomike. Prej vitit 2015 KOSTT-i nuk ka ndarë bursa për studentë të FIEK-ut. Drejtuesit e KOSTT-it thonë se janë duke planifikuar që nga viti i ardhshëm të fillojnë përsëri me dhënien e bursave.

KEDS

KEDS-i aktualisht ka 161 inxhinierë të punësuar, moshë mesatare e të cilëve është 42 vjeç. Nga viti 2013, kur KEDS është themeluar, e deri më 2018, nga kjo sipërmarrje janë pensionuar 6 inxhinierë, ndërsa për periudhën 2019-2028 pritet të pensionohen 32 inxhinierë. Pra KEDS-i nuk përballet me pensionim të inxhinierëve, por sipas drejtuesve të tij, sfida kryesore me të cilën ballafaqohen gjatë rekrutimit të kuadrove të reja janë mungesa e shkathtësive profesionale në raport me kërkesat e punës dhe të profesionit, ngaqë në shumicën e rasteve njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në universitet nuk përputhen me botën reale

të punës. Sipas tyre, një sfidë tjetër është edhe pamundësia e gjetjes së kuadrit të duhur në regjione të caktuara të Kosovës. Përparësi punësimi në KEDS kanë studentët nga drejtimi i elektroenergjetikës në FIEK.

Shumica dërrmuese e inxhinierëve të punësuar në KEDS në dhjetë vjetët e fundit janë të diplomuar nga FIEK-u: njëri është nga drejtimi telekomunikacion dhe 63 janë nga drejtimi elektroenergjetikë.

Në periudhën 2013-2019 në kuadër të programit “KEDS Academy” kanë bërë praktikë profesionale 101 studentë të FIEK-ut, që të gjithë nga drejtimi i elektroenergjetikës, prej të cilëve, pas përfundimit të praktikës, 58 kanë lidhur kontratë të rregullt pune me KEDS-in. KEDS-i nuk ka ndarë asnjëherë bursa për studentë të FIEK-ut, por sipas drejtuesve të KEDS-it, investimi i tyre përmes programit “KEDS Academy” është ekuivalent me investimin për dhënien e bursave për studentë, madje edhe më shumë pasi ky program ka kosto shumë të lartë.

TREPÇA

Trepça aktualisht ka 30 inxhinierë të punësuar, prej të cilëve 12 të profilit të elektroteknikës e 18 të mekanikës, moshë mesatare e të cilëve është rreth 50 vjeç. Gjatë 10 vjetëve të fundit në Trepçë janë pensionuar 23 inxhinierë, ndërkaq për 10 vjetët e ardhshëm pritet të pensionohen 21 inxhinierë. Qysh tash kjo ndërmarrje përballet me mungesë inxhinierësh nga këto drejtime të FIEK-ut: elektroenergjetikë, elektronikë dhe

inxhinieri kompjuterike.

Në 10 vitet e fundit në këtë ndërmarrje nuk është punësuar asnjë i diplomuar nga FIEK-u. Të punësuarit në ndërmarrjen «Trepça» janë të diplomuar të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) të Universitetit të Mitrovicës «Isa Boletini» (UMIB), i themeluar nga Kuvendi i Kosovës më 2013.

Në dhjetë vjetët e fundit, asnjë student i FIEK-ut nuk ka kryer praktikë profesionale në ndërmarrjen «Trepça», ndërkaq nga FIMK-u i UMIB-it, rreth 40 studentë kanë kryer praktikë profesionale në këtë ndërmarrje. Sa u takon bursave, drejtuesit e ndërmarrjes «Trepça» thonë se nuk kanë ndarë bursa për studentë asnjëherë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

INFRAKOS

INFRAKOS ka 38 inxhinierë të profileve të ndryshme me moshë mesatare 43 vjeç. Në 10 vjetët e fundit janë pensionuar shtatë inxhinierë, ndërsa në 10 vjetët e ardhshëm pritet të pensionohen tetë inxhinierë. INFRAKOS nuk ballafaqohet me mungesë të inxhinierëve, por me mungesën e përvojës së të diplomuarve, pasi «teoria që studentët mësojnë nëpër fakultete është në shpërputhje me praktikat në ndërmarrjet publike e private».


Profilet që i kërkon kjo ndërmarrje nga FIEK-u janë elektronikë, inxhinieri kompjuterike, elektroenergjetikë dhe telekomunikacion. Në dhjetë vjetët e fundit, në INFRAKOS janë punësuar 11 inxhinierë të diplomuar nga FIEK-u.

Gjashtë studentë nga FIEK-u kanë kryer praktikë profesionale në dhjetë vjetët e fundit në INFRAKOS. Mirëpo, kjo ndërmarrje, për shkak të gjendjes jo të mirë financiare, asnjëherë nuk ka ndarë bursa për studentë.


CONTOUR GLOBAL

Në këtë fazë të projektit Controur Global nuk ka ofruar të dhëna për numrin e të diplomuarve nga programet e studimeve në FIEK që do të mund të punësoheshin në këtë termocentral. Në anën tjetër, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka deklaruar se gjatë ndërtimit të termocentralit «Kosova e Re» do të krijohen 10 mijë vende pune, kurse për operimin e tij do të hapen 500 vende pune. Drejtuesit e «Contour Global» nuk na kanë ofruar të dhëna nëse planifikojnë të organizojnë programe të bursave dhe të praktikës profesionale për studentët e FIEK-ut. Megjithëkëtë, ministri Lluka dhe drejtuesit e «Contour Global» kanë konfirmuar se do të krijohet Fondi për Zhvillimin e Komunitetit përreth vendit ku do të ndërtohet termocentrali. Njëri prej qëllimeve të këtij fondi do të jetë zhvillimi i shkathtësive të të rinjve në fushën e energjisë.³³


Punësimet aktuale në industri



Penisionimet në industri



Praktikat profesionale në industri





Përfundime

- FIEK-u ka gjithsej 36 pjesëtarë të stafit akademik (15 burra e 9 gra). Moshja mesatare e profesorëve të rregullt është 58 vjeç; e profesorëve të asocuar 51; e profesorëve asistentë 50; në total, moshja mesatare e profesorëve me angazhim të rregullt është 53 vjeç. Një në katër pjesëtarë të stafit akademikë është i angazhuar edhe në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë publik ose privat. Përpjesa profesor-studentë gjatë procesit të ligjëratave është 1:43, e në provime, ku përveç studentëve të rregullt hyjnë edhe ata përsëritës, përpjesa rritet në 1:76. Gjysma e stafit akademik janë me formim akademik tërësisht vendor. Asnjë pjesëtar i stafit nuk i ka mbaruar të gjitha nivelet e studimit jashtë vendit e në gjuhë të huaj. Studimet PhD vetëm 5 pjesëtarë të stafit akademik i kanë mbaruar jashtë vendit e në gjuhë të huaj.
- Programet e studimit elektroenergjetika dhe automatika kanë shpërputhje mes numrit të profesorëve të pensionuar dhe numrit të profesorëve e të asistentëve të rinj të kërkuar me konkurs. Kjo shpërputhje është edhe më e madhe kur të kihet parasysh se këto konkurse nuk kanë qenë domosdoshmërisht për pozita të reja mësimdhënëse, por edhe për rishpallje dhe për avancime të pozitave ekzistuese mësimdhënëse.
- Mospërtëritja e stafit akademik, veçmas në departamentin e elektroenergjetikës, është menaxhuar me angazhimin shtesë të profesorëve të pensionuar deri në moshën 70 vjeçare, duke e bërë këtë departament me më së shumti angazhime shtesë të profesorëve të pensionuar.
- Në departamentin e elektroenergjetikës nuk ka pasur asnjëherë asistentë me angazhim të rregullt, përveç në vitin 2018, e pozitat e asistentëve të rregullt vazhdimisht janë plotësuar me asistentë të jashtëm.
- Drejtimi i inxhinierisë kompjuterike ka regjistrimin më të madh dhe më stabil të studentëve të rinj në periudhën 2012-2019, ndërkaq drejtimi i elektroenergjetikës, ndonëse me drejtimin e inxhinierisë kompjuterike në fillim të kësaj periudhe kishte numër të njëjtë të studentëve të rinj të regjistruar, në tre vjetët e fundit ka pasur gati përgjysmim të numrit të studentëve të rinj të regjistruar. Përgjysmim të tillë ka pasur edhe në drejtimin e automatikës, kurse në drejtimit e telekomunikacionit dhe të elektronikës ka pasur rënie të lehtë.

- Nga pasqyrat e numrit të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike të periudhës 2012-2019 në të gjitha drejtimet e FIEK-ut vërehet se në vitin e dytë të studimeve numri mesatar i studentëve të regjistruar për herë të parë është për gjysmë më i vogël sesa në vitin e parë. Vërehet edhe se numri mesatar i studentëve të regjistruar për herë të dytë e më shumë është më i madh në vitin e tretë, madje ky numër i studentëve përsëritës në vitin e tretë është pothuajse i njëjtë me numrin e studentëve të rinj të regjistruar në vitin e parë.
-
- Sikurse në nivelin BA, numri më i madh i studentëve përsëritës në MA është në vitin e fundit të studimeve. Përderisa në nivelin BA numri total i studentëve të regjistruar në vitin e parë është pothuajse i njëjtë me numrin total të studentëve të regjistruar në vitin e fundit, në nivelin MA numri total i studentëve të regjistruar në vitin e dytë është dyfish më i madh sesa në vitin e parë të studimeve. Pra ka zvarritje të kohëzgjatjes së studimeve të nivelit MA.
- Raporti gjinor në të dyja nivelet, BA dhe MA, është 37% studente e 63% studentë. Ky raport gjinor është konstant nëpër të gjitha vitet dhe nivelet e studimeve.
- Në periudhën 2012-2019 nga numri i studentëve prej të gjitha drejtimeve të FIEK-ut që kanë fituar bursë nga UP-ja, $\frac{2}{3}$ janë studentë që kanë marrë bursë për vitin e parë të studimeve, e vetëm $\frac{1}{3}$ e tyre kanë arritë të marrin bursë për vitin e dytë. Kjo flet për vështirësitë e studentëve për t'i përfunduar me kohë të gjitha provimet e vitit të dytë me notë mesatare mbi 8. Prej bursave, 75% i kanë marrë studentët e inxhinierisë kompjuterike, nga 10% i kanë marrë studentët e elektroenergjetikës dhe të telekomunikacionit, kurse më së paku studentë bursistë kanë pasur elektronika (4%) dhe automatika (1%).
- Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të stafit të rregullt e të angazhuar akademik të FIEK-ut, por edhe me përgjegjësit dhe ish-përgjegjësit e programeve studimore në FIEK, rezulton se:
 - Ekziston rreziku që të mbyllet drejtimi i elektroenergjetikës për shkak të pensionimit të stafit të rregullt akademik. Kjo situatë është rënduar sidomos viteve të fundit, meqë stafi i rregullt akademik i ka takuar gjeneratës së njëjtë, e kjo ka bërë që brenda një viti të pensionohen nga disa profesorë përnjëherë;
 - Përveç pensionimit, shkaktar tjetër është mospërtëritja e stafit akademik. Pjesëtarët e gjeneratës së mesme që do të mund t'i zëvendësonin profesorët e pensionuar, pas luftës 1998-1999 nuk patën interesim për angazhim në akademi, sepse gjetën punë me të ardhura më të mëdha. E njëjta ndodhi edhe me pjesëtarët e gjeneratës së re – studentët e mirë i mori tregu i punës me shpërblime më të mëdha se universiteti, por nuk pati prurje as të studentëve me sukses të mirë. Veç

- këtyre, disa herë dështuan konkurset për shkak të mosinteresimit të kandidatëve, e kishte edhe raste kur konkurset dështuan për shkak të kandidatëve të dobët;
- Një tjetër arsye pse nuk është përtëritur stafi i rregullt akademik në FIEK është mungesa e programit për studimet PhD viteve të fundit, ndonëse edhe kur ky program ishte i akredituar, asnjë student nuk arriti të regjistrohej, meqë UP-ja nuk hapi konkurs: për shkak të mungesës së stafit akademik dhe / ose për shkak të ndërrimit të rektorëve;
 - Ka kandidatë nëpër ndërmarrje të ndryshme, si KEK, KOSTT, KEDS etj., që kanë doktoratura nga universitete të njohura, shumë prej të cilëve nuk kanë qenë të interesuar për karrierë akademike për shkak të të ardhurave më të ulëta, pastaj procedurave të tejzgjatura burokratike për pranimin e stafit të ri, si dhe mosplotësimin të kriterëve siç është numri i publikimeve në revista kredibile;
 - Për të punësuar kuadro të reja, UP-ja fillimisht duhet të marrë leje për rritje stafi nga Ministria e Financave, e cila gjithmonë refuzon me arsyetimin se nuk ka mjete financiare;
 - Një tjetër pengesë është kriteri moshor – 30 vjeç për asistentët e 50 vjeç për profesorët – e që sipas aplikantëve për poste është diskriminues dhe kriter që nuk e ka asnjë universitet publik. Madje, IAP ka rekomanduar që të rishqyrtohet vendimi i Senatit të UP-së që kufizon moshën për t'u zgjedhur mësimdhënës, si dhe që të ndalohet diskriminimi moshor në punësim. Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë aktgjykimin për anulimin e vendimit të Senatit të UP-së për kriteret moshore dhe ka aprovuar rekomandimin e IAP-së si të bazuar;
 - Po qe se mbyllet programi studimor i elektroenergjetikës në FIEK, atëherë pasojat afatgjate janë të paparashikueshme, por pasoja afatmesme do të jetë mungesa e kuadrove inxhinierike për ndërmarrjet energjetike ekzistuese (KEK, KOSTT, KEDS, etj.) dhe për gjithë ekonominë e Kosovës, sepse do të krijohet boshllëk i bartjes së njohurive dhe eksperiencës inxhinierike nga gjenerata në gjeneratë. Shkëputja e kontinuitetit të prodhimit të kuadrove të reja do të këtë pasoja të mëdha në funksionimin dhe zhvillimin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës. E gjithë kjo për arsye se FIEK-u është i vetmi institucion i arsimit të lartë që ofron këtë program të akredituar studimesh e që prodhon kuadro për sistemin elektroenergjetik në krejt Kosovën.
- Duke pasur parasysh alarmimet në publik për rrezikun e mbylljes së programit të studimit të elektroenergjetikës në FIEK, Qeveria e Kosovës ka aprovuar themelimin e Grupit Punues për të shqyrtuar mungesën e kuadrove dhe të ardhmen e drejtimit elektroenergjetikë në UP. Ndonëse për këtë ka pasur takime të institucioneve të ndryshme, deri më tani nuk ka diçka konkrete për zgjidhjen e kësaj problematike, përveç shpalljes së konkursit për staf të rregullt akademik më 22 tetor 2019, që

është konkursi më i madh për nga numri i mësimdhënësve të rregullt të kërkuar për elektroenergjetikë që nga viti 2012.

- Nga ndërmarrjet e marra në shqyrtim - KEK, KOSTT, KEDS, TREPÇA dhe INFRAKOS - rezulton se:
 - aktualisht janë 697 inxhinierë të punësuar,
 - 235 prej tyre janë punësuar në dhjetë vjetët e fundit;
 - në dhjetë vjetët e fundit janë pensionuar gjithsej 190 inxhinierë;
 - në dhjetë vjetët e ardhshëm pritet të pensionohen 291 inxhinierë;
 - 574 studentë kanë përfunduar praktikën profesionale.
- Nga këto ndërmarrje, KOSTT është e vetmja që ka ndarë bursa për studentë. Gjatë periudhës 2010-2014 KOSTT ka ndarë 48 bursa për studentë të FIEK-ut, në vlerë prej 1.200 eurosh në vit, që në total i bie 57.600 euro. Prej këtyre bursave, 28 kanë qenë për studentët e drejtimit sisteme elektroenergjetike.
- Controur Global në këtë fazë të projektit nuk ka ofruar të dhëna për numrin e të diplomuarve nga programet e studimeve të FIEK-ut që do të mund të punësoheshin në këtë termocentral, e as të dhëna nëse planifikojnë të organizojnë programe të bursave dhe të praktikës profesionale për studentët e FIEK-ut.

Rekomandimet

Dekanati i FIEK-ut dhe Rektori i UP-së, me mbështetje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe nga Ministria e Financave (MF), si dhe nga industria, të ofrojë bursa për studentët e dalluar, si dhe për asistentët e rregullt për studime doktorature në universitete evropiane, me kushtin që pas përfundimit të kthehen për angazhim të rregullt akademik në FIEK. Po ashtu, kuadrove të pranuar në FIEK që janë duke bërë doktoraturën jashtë vendit të mos u shkëputet kontrata e punës;

Dekanati i FIEK-ut dhe Rektori i UP-së, me mbështetje nga MASHT dhe nga MF, të eliminojë pengesat buxhetore në rekrutimin e stafit të ri akademik të rregullt në FIEK për drejtime të veçanta që janë me interes nacional, siç është elektroenergjetika;

Të krijohet një mekanizëm nga Dekanati dhe Rektori që do ta monitoronte gjendjen e stafit akademik nëpër departamente të FIEK-ut, në mënyrë që konkurset për staf të rregullt akademik të shpallen më shpesh e në përputhje me nevojat, jo duke ndjekur praktikën e deritashme të shpalljes

së konkurseve gati një herë në dy vjet për të gjitha fakultetet njëherësh. Po ashtu, mekanizmi i lartpërmendur të sigurohet që të paktën gjashtë muaj para se të dalë në pension një pjesëtar i stafit të rregullt akademik, të shpallet konkursi ose të nisnin procedurat për avancimin e asistentit të tij/saj;

Krijimi i kuadrove merr kohë, prandaj të shikohet mundësia që të doktoruarve që i plotësojnë kushtet statutorë për angazhim të rregullt, e që janë të punësuar në industri, t'u ofrohen incentiva për t'u angazhuar në akademi;

Të rritet buxheti për hulumtime shkencore dhe FIEK-u të jetë edhe institucion që gjeneron vetë të ardhura, duke krijuar institute për hulumtime shkencore dhe ekspertiza të ndryshme për ndërmarrje dhe institucione të vendit, në mënyrë që të ketë një lidhshmëri mes universitetit dhe industrisë.

Fundnotat

1. “Elektroenergjetika rrezikon mbylljen për shkak të mungesës së kuadrove profesionale”, gjendet në: <https://kallxo.com/gjate/analize/elektroenergjetika-rrezikon-mbylljen-per-shkak-te-mungeses-se-kuadrove-profesionale/>
2. Udhëzimi administrativ për akreditim mund të gjendet në këtë link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17952>
3. Vendimi mbi Akreditimin 2014, mund të gjendet në: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/latest-events/cat_view/3-evaluations/293-raportet-e-vleresimit/297-institucionet-publike/305-universiteti-i-prishtines-hasan-prishtina/488-fakulteti-i-inxhinierise-elektrike-dhe-kompjuterike/546-2014
4. Vendimi mbi Akreditimin 2017/1, mund të gjendet në: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/latest-events/cat_view/3-evaluations/293-raportet-e-vleresimit/297-institucionet-publike/305-universiteti-i-prishtines-hasan-prishtina/488-fakulteti-i-inxhinierise-elektrike-dhe-kompjuterike/808-2017
5. Vendimi mbi Akreditimin 2018/1, mund të gjendet në: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/latest-events/cat_view/3-evaluations/293-raportet-e-vleresimit/297-institucionet-publike/305-universiteti-i-prishtines-hasan-prishtina/488-fakulteti-i-inxhinierise-elektrike-dhe-kompjuterike/809-2018
6. Vendimet mbi Akreditimin 2013, mund të gjenden në: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/latest-events/cat_view/3-evaluations/293-raportet-e-vleresimit/297-institucionet-publike/305-universiteti-i-prishtines-hasan-prishtina/488-fakulteti-i-inxhinierise-elektrike-dhe-kompjuterike/545-2013
7. Intervistë me dekanin e FIEK-ut, Enver Hamiti, 26 korrik 2019 dhe 18 shtator 2019.
8. Intervistë me dekanin e FIEK-ut, Enver Hamiti, 18 shtator 2019.
9. CV-të e pjesëtarëve të stafit akademik të FIEK-ut mund të gjenden në këtë link: <https://fiek.uni-pr.edu/Personeli/Personeli-Akademik.aspx>
10. Po aty, faqe 27. Po ashtu, janë përdorur edhe pasqyrat e numrit të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2018-2019.
11. “Stafi akademik i UP-së”, ADMOVERE, 2018, Prishtinë, faqe 15.
12. Po aty.
13. Konkursi mund të gjendet në këtë link: <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/D90D63E5-661E-44FC-AA51-B9831D5AAF94.pdf>
14. Intervistë me prof. asoc. dr. Avni Skeja, 17 tetor 2019, Prishtinë.
15. Intervistë me prof. dr. Myzefere Limani, 11 tetor 2019, Prishtinë.
16. Po aty.

17. Intervistë me prof. asoc. dr. Mimoza Ibrani, prodekane per çështje akademike, 15 tetor 2019, Prishtinë.
18. Intervistë me prof. asoc. dr. Sabrije Osmani, 18 tetor 2019, Prishtinë.
19. Intervistë me prof. asoc. dr. Vjollca Komoni, 11 tetor 2019, Prishtinë.
20. Intervistë me prof. ass. dr. Gazmend Kabashi, 29 gusht 2019, Prishtinë.
21. Intervistë me prof. dr. Enver Hamiti, 18 shtator 2019, Prishtinë; me prof. dr. Mimoza Ibrani, 15 tetor 2019, Prishtinë; dhe me prof. asoc. dr. Avni Skeja, 17 tetor 2019, Prishtinë.
22. Intervistë me prof. asoc. dr. Vjollca Komoni, 11 tetor 2019, Prishtinë.
23. Po aty.
24. Po aty.
25. Intervistë me prof. dr. Ruzhdi Sefa, 17 tetor 2019, Prishtinë.
26. Intervistë me prof. asoc. dr. Vjollca Komoni, 11 tetor 2019, Prishtinë.
27. Intervistë me prof. ass. dr. Gazmend Kabashi, 29 gusht 2019, Prishtinë.
28. Intervistë me prof. dr. Myzefere Limani, 11 tetor 2019, Prishtinë; dhe me prof. dr. Lule Ahmedi, 11 tetor 2019, Prishtinë.
29. Intervistë me prof. asoc. dr. Mimoza Ibrani, prodekane per çështje akademike, 15 tetor 2019, Prishtinë; dhe me prof. asoc. dr. Sabrije Osmani, 18 tetor 2019, Prishtinë.
30. Intervistë me prof. asoc. dr. Sabrije Osmani, 18 tetor 2019, Prishtinë; dhe me ekspertin Mr. Sc. Avni Alidemaj, 21 tetor 2019, Prishtinë.
31. Intervistë me prof. dr. Luan Ahma, 18 tetor 2019, Prishtinë; dhe me prof. dr. Mimoza Ibrani, 15 tetor 2019, Prishtinë.
32. Intervistë me prof. dr. Luan Ahma, 18 tetor 2019, Prishtinë.
33. Intervistë me prof. dr. Ruzhdi Sefa, 17 tetor 2019, Prishtinë.
34. Statuti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, mund të shkarkohet nga: www.uni-pr.edu në kategorinë "më shumë" nën fjalën "STATUTI".
35. Intervistë me ekspertin Mr. Sc. Avni Alidemaj, 21 tetor 2019, Prishtinë; dhe me prof. asoc. dr. Lavdim Kurtaj, 11 tetor 2019, Prishtinë.
36. Ex officio nr. 170/2010 lidhur me Vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës për kufizimin e moshës në rekrutimin e mësimdhënësve pa përvojë akademike, Institucioni i Avokatit të Popullit, 30 gusht 2010.
37. Vendim Ref .nr 1/499, Senati i Universitetit të Prishtinës, 25.05. 2010.
38. Aktgjykimi A.nr. 1242/2010, Gjyktata Themelore Prishtinë, 09.12.2013.
39. Opinion Juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në Cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curie) A.nr.547/2018, Institucioni i Avokatit të Popullit, 2 gusht 2019.
40. Intervistë me Mr. Sc Avni Alidemaj, Prishtinë, 21 tetor 2019.
41. Intervistë me Mr. Sc Lavdim Kurtaj, Prishtinë, 11 tetor 2019.

42. Për këtë shih: <https://www.usaid.gov/kosovo/infographics/usaid-repower>
43. Për këtë shih: <https://millenniumkosovo.org/we-women-in-energy-scholarship-program-launched-today-in-prishtina/> dhe <https://www.mcc.gov/blog/entry/blog-032619-womens-history-month-kosovo/>
44. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 12/98, 18 prill 2019.
45. Intervistë me Larissa Testoni, 30 shtator 2019, Prishtinë. Shih po ashtu edhe: <https://www.koha.net/arberi/66161/neser-publikohet-kontrata-per-kosoven-e-re>.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

378.1(496.51)(047.53)

Gjendja në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe
Kompjuterike (FIEK) / ky raport u hartua nga Aulonë
Memeti, Ardit Kika. - Prishtinë : ADMOVERE, 2019. -
27 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

1.Memeti, Aulonë 2. Kika, Ardit

ISBN 978-9951-8961-6-0

